

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 334, Datë 18.12.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 41, DATË 14.02.2025
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN PLUS ENERGY” SH.P.K.,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2822/1 prot., datë 17.12.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 14.02.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “GREEN PLUS ENERGY ” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 41, datë 14.02.2025, ka licencuar shoqërinë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Me vendimin nr. 41, datë 14.02.2025, në pikën 2 është përcaktuar se shoqëria duhet të raportojë në ERE çdo 6 (gjashtë) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit, në kuadër të VNM-së paraprake, e cila është e vlefshme deri më 17.07.2026, ndërsa në pikën 3 të po këtij vendimi është parashikuar se shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.08.2025; gjithashtu, në pikën 4 është përcaktuar se me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i administruar

- Shoqëria “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k., me shkresën e datës 05.11.2025, protokolluar në ERE me nr. 2821 prot., datë 10.11.2025, ka informuar mbi fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltai, pas zbardhjes së lejes së ndërtimit nr. 615/9 prot., datë 13.10.2025, sipas Vendimit nr. 23, datë 02.04.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
- Shoqëria ka depozituar pranë ERE-s dokumentacionin përkatës mbi njoftimin e institucioneve kompetente, hapjen e adresës dytësore në QKB, si dhe aktet procedurale që provojnë fillimin e punimeve më datë 03.11.2025.
- Me të njëjtën shkresë, shoqëria ka kërkuar rishikimin e afatit të përcaktuar për fillimin e operimit, të parashikuar në pikën 3 të vendimit nr. 41/2025.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 41, datë 14.02.2025, lidhur me fillimin e punimeve të ndërtimit brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.
- Afati i fillimit të operimit i përcaktuar në pikën 3 të vendimit nr. 41/2025 është bazuar në vetëdeklarimin e shoqërisë në fazën e aplikimit për licencim, në një moment kur leja e ndërtimit nuk ishte zbardhur.
- Leja e ndërtimit nr. 615/9 prot., datë 13.10.2025, është e vlefshme për një periudhë 12-mujore, çka krijon nevojën për harmonizimin e afatit të operimit me këtë leje dhe me kontratën e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Përmbushja e kushtit të pikës 2 sjell nevojën për shfuqizimin e tij, si dhe riformulimin përkatës të pikës që parashikon rishikimin e vendimit.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se:
- Pika 2 e vendimit nr. 41, datë 14.02.2025, vlerësohet të shfuqizohet, pasi kushti i vendosur është përmbushur.
- Pika 3 e po këtij vendimi vlerësohet të ndryshohet me qëllim reflektimin e afatit të ri për fillimin e operimit, konkretisht “*Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë brenda datës 13.10.2026*”.
- Ndërsa pika 5 e vendimit vlerësohet të riformulohet, për të reflektuar shfuqizimin e pikës 2 dhe për të ruajtur koherencën e brendshme të aktit administrativ, konkretisht “*Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kuadër të plotësimit të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi*”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimit e ERE-s nr. 41, datë 14.02.2025 si vijon:

- a. Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 41, datë 14.02.2025, shfuqizohet.
- b. Pika 3 ndryshon dhe bëhet:
“Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 13.10.2026.
- c. Pika 5 ndryshon dhe bëhet:
“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të plotësimit të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi.”

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI